



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 13, datë 14.01.2021

PËR NDËRPRERJEN DHE PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR MAGJISTRATIN Z. XHEVAHIR LITA, KANDIDAT PËR T'U KOMANDUAR INSPEKTOR PRANË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË.

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 159, pika 2, germa "a", 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, neneve 32, 35, 53, pika 3 dhe 55, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në pikën 6, Seksioni B, Kreu V, në germën "ç", të pikës 8, të Seksionit Ç, të Kreut VI, të Vendimit nr. 171, datë 27.9.2019, Rregullores "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin "Për ndërprerjen dhe procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të magjistratit, kandidat për t'u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Xhevahir Lita", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit për t'u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Xhevahir Lita, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Të njoftohet për këtë vendim z. Xhevahir Lita.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA



ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKAJ

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

